



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 53 dt. 22.08.2014

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 22.08.2014, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Mbi ndërhyrjet në rikonstrukcionet e kalldrëmeve të disa rrugëve dhe rrugicave në Gjirokastrë, në projekte të hartuara nga Bashkia Gjirokastrë si më poshtë vijon:
 - Rikonstrukcioni i rrugës Alqi Kondi, (segmenti Shtëpia e pritjes- I Cumaku)
 - Rikonstrukcioni i rrugës “Astrit Karagozi” (Dunavat-lagja Partizani).
 - Rikonstrukcioni i rrugës me Kalldrëm të Vezirit në L. Pazar i Vjetër.
 - Sistemimi i rrugës “Kapo Baco” (Gurgai-Varosh).
 - Sistemimi i rrugicave në L. Palorto pranë Hajdinit (rruga Karaifil Bello).
 - Rikonstrukcioni i rrugës “Dr. Laboviti” dhe “Foto Berberi” + Sokaku i të Marrëve (pranë shtëpisë së Ismail Kadaresë).

Të ngrihet një grup ekspertësh nga Ministria e Kulturës, Instituti i Monumenteve të Kulturës, i cili duhet të bëjë një relacion të detajuar lidhur me ndërhyrjet e parashikuara në projektet e hartuara nga Bashkia Gjirokastrë. Pas hartimit të këtij relacioni dhe dhënies së sugjerimeve nga grupi i ekspertëve do të merret vendimi i cili do t'i bëhet me dije dhe Bashkisë Gjirokastrë.

2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI